



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:067980
Datë: 29.01.2025
Numri i dokumentit: 06774168

P.nr.203/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me bashkëpunëtoresh profesionale Leonita Lajqi-Muçaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.H, nga Istogu, për shkak të veprës penale “Rrezikimi i trafikut publik” nga neni 370 paragrafi.8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.32/2024 të datës 29.02.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, të mbajtur me datën 20.01.2025, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, nga Prokuroria Themelore në Pejë, të dëmtuarës V.P, të pandehurit A.H, mbrojtësit të pandehurit av.Arbër Osmanaj, nga Prishtina, sipas autorizimit, me datën 23.01.2025, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 29.01.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

A.H, i lindur me datë, në Istog, me vendbanim në rr. “.....”, nr., Komuna e Istogut, nga i ati A. dhe nëna Sh., e vajzërisë, i martuar, baba i ... fëmijëve, me profesion, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal, posedon nr. tel....., i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri**.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak së:

Me datën 05.11.2023 rreth orës 17:20, në aksin rrugor Radavc-Pejë, në fshatin Novosellë K. Pejë, nga pakujdesia shkel nenin 53 të Ligjit mbi Rregullat e Trafikut Rrugor, në atë mënyrë që, gjersa i pandehuri po qarkullonte me veturën e tij të tipit, ngjyrë hiri, me targa, kur arrin në vendin e lartcekur duke mos ju përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës dhe duke mos i kushtuar kujdes këmbësorës-të dëmtuarës V.P, e cila ishte në përfundim të kalimit të rrugës, edhe pse i pandehuri frenon në një gjatësi prej 3.70 metra por i njëjti nuk arrin të ndalet dhe me pjesën e parë të krahut të djathtë të veturës e godet të dëmtuarën në pjesën e djathtë të trupit, të cilën nga goditja e përplas për asfalt, e si pasojë e goditjes e njëjta pëson lëndime trupore,

- Me çka ka kryer veprën penale **“Rrezikimi i trafikut publik”** nga neni 370 par.8 e lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në mbështetje të nenit 4, 7, 10, 17, 23, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 71, 72 dhe neni 370 par.8 e lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së, si dhe konform dispozitave ligjore të nenit 358, 364, 449, 450, 452 dhe 462 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

- I.** Me **DËNIM BURGIMI**, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit dhe konform neni 44 par.1 dhe 2 të KPRK-së, i **ZËVENDËSOHET ME DËNIM ME GJOBË** në shumë prej njëmijepesëqind (1500) euro, të cilin dënim me gjobë obligohet që ta paguaj në afat prej tre (3) muajsh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II.** Nëse i pandehuri refuzon, dështon apo nuk e paguan dënimin e shqiptuar me gjobë në afatin e caktuar, dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim burgimi duke iu llogaritur shuma prej njëzetë (20) euro për një (1) ditë burgimi. Nëse i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim. Nëse i njëjti e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit me burgim ndërpritet.
- III.** **OBLIGOHET** i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale për paushallin gjyqësorë të paguaj shumën prej tridhjetë (30) euro, në emër të ekspertizës së komunikacionit shumën prej njëqind (100) euro, ndërsa në emër të akt ekspertimit mjekoligjor shumën prej njëzetë (20) euro, si dhe në emër të Fondit për Mbrojtjen e Viktimave në shumën prej njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit të detyrueshëm.
- IV.** E dëmtuara V.P, nga fshati, Komuna e Pejës, rr.”.....”, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me datë 29.02.2024, ka ngritur aktakuzën PP/II.Nr.32/2024, ndaj të pandehurit A.H, për shkak të veprës penale **“Rrezikimi i trafikut publik”** nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 20.01.2025, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj nga Prokuroria

Themelore në Pejë, e dëmtuara V.P, i pandehuri A.H, si dhe mbrojtësi me autorizim i të pandehurit av.Arbër Osmanaj, nga Prishtina.

Në këtë seancë, gjykata në pajtim me nenin 241 par.1 të KPPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurin A.H, për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaron për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmit e tij, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe provueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Para leximit të aktakuzës, gjykata pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe nuk ka nevojë për sqarime shtesë. Gjykata e ka njoftuar të pandehurin për pasojat dhe privilegjet e pranimit të fajësisë, dhe pasi që është bindur së i pandehuri e ka kuptuar përparësitë dhe pasojat e pranimit të fajësisë, të i njëjtit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për fajësinë apo pafajësinë.

I pandehuri A.H, i ftuar që të deklarohet për fajësinë apo pafajësinë, ka deklaruar së e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, respektivisht për veprën penale “Rrezikimi i trafikut publik” nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së.

Në vlerësimin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit A.H, gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, i cila ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit. Më pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit të lartcekur është pajtuar e dëmtuara V.P, po ashtu edhe mbrojtësi i të pandehurit A.H, av.Arbër Osmanaj, i cili ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim, e mbështesë këtë pranim fajësie, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare në konsultim me mua si mbrojtës dhe pas sqarimit të pasojave të pranimit të fajësisë të cilat edhe në këtë seancë ju sqaruan dhe ky pranim gjënë mbështetje edhe në provat dhe faktet e çështjes ndërsa aktakuza nuk ka të meta ligjore.*

Gjyqtarja e vetme gjykuese duke vlerësuar pranimin e fajësisë së bërë nga ana e të pandehurit, në raport me nenin 242 par. 2 nën par. 2.1 e deri 2.4 të KPPRK-së, vlerësoi dhe gjeti së i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, së këtë pranim të fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, dhe pasi që iu janë komunikuar të gjitha të drejtat sipas KPPRK-së, së një pranim i tillë i fajësisë ka mbështetje në faktet e çështjes si dhe në materialet e dorëzuara nga Prokuroria siç janë: *Procesverbali mbi vend shqimin e aksidentit. I dt. 12.11.2023, Deklarata e të pandehurit A.H, e dt.05.11.2023, Deklarata e të dëmtuarës V.P, e dt 11.11.2023, Procesverbali i aksidentit, i dt.05.11.2023, Raporti Mjeksorë me nr. 26680 i dt. 05.11.2023 nga Spitali i Përgjithshëm Pejë, Foto-Albumi, Ekspertiza Mjeko-Ligjore e dt. 09.01.2024, Ekspertiza e komunikacionit, e dt.06.02.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje të pandehurin në procedurë paraprake, i dt.29.02.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje të dëmtuarën në procedurë paraprake, i dt. 29.02.2024 dhe së aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që në bazë të nenit 242 par.6 të KPPK-së, me aktvendim ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se i pandehuri*

ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimi të fajësisë dhe se i pandehuri e ka pranuar fajësinë pa presion dhe me vullnetin e tij të plotë, duke vazhduar me shqiptimin e dënimi.

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit konform nenit 356 të KPPRK-së, pasi që nuk ka nevojë për një seancë të tillë, gjykata ka vazhduar seancën duke i ftuar palët që të deklarohen në fjalën e tyre lidhur me rrethanat për shqiptimin e dënimit.

Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, ka deklaruar se: *sa i përket rrethanave rënduese ia le në vlerësim gjykatës ndërkaq si rrethanave lehtësues i propozoj gjykatës të marrë parasysh pranimin e fajësisë.*

E dëmtuara V.P, ka deklaruar se: *dëshiroj të parashtoj kërkesë pasurore juridike, dëshiroj që i pandehuri të dënohet sipas ligjit, i pandehuri nuk me ka kërkuar falje, i pandehuri ka ardhur në Spital për të më vizituar.*

Mbrojtësi i të pandehurit, av. Arbër Osmanaj, ka deklaruar se: *i propozoj gjykatës që si rrethana lehtësuese të marr parasysh sjelljen e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale dhe atë faktin që i pandehuri menjëherë pas aksidentit të dëmtuarës e ka dërguar në Spitalin Rajonal të Pejës, sjelljen e të pandehurit në procedurë që i pandehuri menjëherë në fazat fillestare ka sqaruar të gjithë ngjarjen dhe ka pranuar veprimet e tij të cilat me pas janë konstatuar në mënyrë të njëjtë edhe me ekspertizë që i pandehuri i është paraqitur familjes së të dëmtuarës duke i shprehë gatishmëri për ndihmë financiare nëse do ta kërkonte trajtimi mjekësor i të dëmtuarës, që i pandehuri asnjëherë të vetme nuk ka rënë ndesh me ligjin dhe ky rast është rasti i parë që në çfarëdo forme është proceduar ndaj të pandehurit, shprehjen e keqardhjes, kërkim faljen, si dhe si rrethanë veçanërisht lehtësues pranimin e fajësisë, për çka i propozoj gjykatës që i shqiptoj gjykatës një dënim nën ripunimin e paraparë ligjor dhe nëse gjykata i shqipton dënim në kohëzgjatje deri në gjashtë muaj në kuptim të nenin 44 i propozojmë gjykatës që me pëlqimin e të pandehurit, dënimi me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë.*

I pandehuri A.H, ka deklaruar se: *pajtohem në tërësi me deklarinimin e mbrojtësit tim, i kërkoj falje të dëmtuarës, i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem me i kujdesshëm, unë kam tentuar që pas aksidentit ti takoj të njëjtit mirëpo kjo ka arritur të behet vetëm pas ditës së tretë, me bashkëshorten dhe gruan e axhës dhe ju kam kërkuar falje për këtë që ka ndodhur, po ashtu edhe pas lirim të spitalit nga e dëmtuara, unë kam kërkuar që të shkoj ti takoj por nëna e saj me ka thënë që nuk ke nevojë për ta parë sepse e keni kryer në spital. Po ashtu në rast se gjykata vendos që unë të dënohem me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh unë jam pëlqimin që ky dënim të me zëvendësohet me gjobë.*

Nga faktet e vërtetuara nga shkresat e lëndës, nga deklarinimet e palëve në procedurë dhe nga vet pranimi i fajësisë nga i pandehuri, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit, ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si dhe vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtor të njëjtin pasi që më parë gjeti se penalisht është përgjegjës.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që ndaj të pandehurit si rrethana lehtësuese ka marr parasysh faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë në tërësi për veprën penale që akuzohet, ka shprehur keqardhje dhe pendim të thellë, se i njëjti është mbajtës i familjes 5 antarëshe, i ka kërkuar falje të dëmtuarës në prani të gjykatës, sjelljen e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale i cili pas aksidentit të dëmtuarën e ka dërguar në Spitalin Rajonal të Pejës, faktin që ka qenë hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin dhe që nga ajo kohë i njëjti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të kryerjes së ndonjë veprë penale tjetër, premtimin që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, si rrethana rënduese përtej elementeve të veprës penale gjykata nuk konstatoi në këtë rast, dhe duke u nisur nga të gjitha këto gjykata të pandehurit i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, të cilin dënim konform nenit 43 dhe 44 të KPRK-së, i'a ka zëvendësuar me dënim me gjobë.

Gjykata në bazë të nenit 44 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, ku përcaktohet se: *“Kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj, gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënimi me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, me pëlqimin e personit të dënuar”*, me pëlqimin e të pandehurit dënimin me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, ia zëvendësoi në dënim me gjobë në shumë prej njëmijepesëqind (1500) euro, e kjo sipas pëlqimit të cilin e ka dhënë i pandehuri A.H e poashtu edhe mbrojtësi i tij me autorizim av.Arbër Osmanaj, shprehimisht në procesverbalin e seancës fillestare të datës 20.01.2025.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar me burg efektiv e pastaj i zëvendësuar në dënim me gjobë me pëlqimin e të pandehurit, ndaj të njëjtit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 69 par.3 të KPRK-së, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurin është i përballueshëm për kushtet ekonomike të tij.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, ekspertizës mjekoligjore, ekspertizës së komunikacionit si dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2, nën par. 2.1 dhe nën par. 2.6, të KPRK-së, ndërsa konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit bazuar në nenin 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, ashtu që të dëmtuarën V.P, e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko – civil.

Mbi bazën e të dhënave si më lart dhe në mbështetje të nenit 242 dhe 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.203/24, me datën 29.01.2025.

B.Profesionale:

Gjyqtarja e vetme gjykuese:

Leonita Lajçi Muçaj

Blerta KERMENDI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.